



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.232/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partija Kosovskih Srba (PKS) me seli në Leposaviq, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 18.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Kosovskih Srba(PKS), me seli në Leposaviq, subjektit politik Lista Serbe i shqiptohet dënimi me gjobë, në shumë prej 5100,00 (pesëmijë e njëqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

II. REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar ankesa e subjektit politik Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Leposaviq, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lista Serbe, për shkak të bërjes fushatë me persona nën moshën 18 vjeçare.

III. Urdhërohet subjekti politik Lista Serbe, që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, që ta përmirësoj shkeljet e përcaktuar si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i .

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 17.10.2017, nga subjekti politik Partija Kosovskih SRBA, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Leposaviqit, Zoran Todić, nga radhët e subjektit politik Lista Serbe, në faqen zyrtare të Facebook-ut, ka publikuar përmbajtje të ndryshme dhe ngjarje në tubimin afër Kishës Shën Konstatin dhe mbretëresha Jelena, në fshatin Kamenica afër Socanices, ku shihen pjesëmarrja e fëmijëve të mitur, si dhe ka vendosur poster afër shkollës fillore. Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se subjekti politik Lista Serbe ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku pretendohet ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Paneli, pasi që shqyrtoj pretendimet ankimore provat e administruara secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se ankesa është **pjesërisht e bazuar**, për këto arsye:

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka vërtetuar se nga subjekti politik Lista Serbe, janë bërë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, posterat e kandidatëve të këtij subjektit politik janë vendosur në shtylla publike brenda oborrit të shkollës fillore, veprime këto që janë të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen vendosjen e njoftimeve, pllakave dhe posterave ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësira private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitivin –I- të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së Lista Serbe, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur dhe për të evituar shkeljen ashtu që subjekti në fjalë nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të caktuar nga PZAP-i. Mos përgjigja e tyre dhe mos ndërmarrja e masave përmirësuese ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitivin –I- të këtij vendimi .

Me pjesën II të dispozitivit, paneli e refuzoi ankesën e subjektit politik Partija Kosovskih Srba (PKS), me seli në Leposaviq, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Lista Serbe, për shkak të bërjes fushatë me persona nën moshën 18 vjeçare, për arsye se, nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk kanë asnjë element të fushatës zgjedhore kurse nga postimi i bërë në foto nuk vërehet se ata kanë qenë duke promovuar ndonjë material zgjedhorë të subjektit në fjalë. Me këtë rast paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, ka dështuar që pretendimet e veta ta argumentoj me fakte në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Paneli konform nenit 120.1 pika a) të LZP-së urdhëroi subjektin politik Lista Serbe që të marrë masa dhe të përmirësoj shkeljet si në pikën –I-të dispozitivit të vendimit në afatin prej 24 orëve dhe nëse subjekti politik Lista Serbe nuk vepron sipas urdhrit të panelit do të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i , në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 232/2017 më datën 18.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevci



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.